



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Un1 Nr.03-81

18.03.2022

Sh k u p

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 pika 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 14 nga Ligji për media („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pika 10 nga Rregullorja për plotësimin e detyrimit për impresium dhe informacion të disponueshme për shfrytëzuesin, ark.nr.01-4443/1 nga 09.10.2018, pika 14 nga Udhëzuesi për përcaktim të afatit për veprimin sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raporti me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-807/1 nga 25.02.2022, dhe në pajtim me Konkluzionin nr.02-320/4 nga 24.01.2020 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1036/4 nga 18.03.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 11-të e mbajtur më 18.03.2022, miratoi si në vijim:

Vendim

për marrjen e masës – vërejtje publike

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media, në mënyrë që transmetuesi në kornizat e shërbimit programor të transmetuar më 18-të shkurt 2022., në pjesën e programeve të transmetuara, nuk ka shpallur të dhëna për të cilat është i detyruar ti publikojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi 1 nga kjo pikë, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-807/1 nga 25.02.2022., e cila është pjesë plotësuese e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

2. **I URDHËROHET** SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Vendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet një kontroll mbikëqyrës, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, a ka vepruar sipas vendimit.

4. Ky vendim është përfundimtar, ndërsa si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e vërtetimit në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencion).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 nga Ligji për media (LM), ka kompetenca të kryejë mbikëqyrje administrative për punën e botuesve të mediave në pajtueshmëri me punën e tyre mbi detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 nga LM.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 pika 1 nga LSHMAV, Këshilli i Agjencisë solli masë vendim - vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligj, në rast të shkeljes së dispozitave nga LSHMAV dhe akteve nënligjore të miratuar në bazë të Ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtueshmëri me nenin 29 paragrafi 2 nga LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund ti marrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAV, duhet të zbatohen dhe në rastet e shkeljes së dispozitave nga LM.

Sipas nenit 14 nga LM, botuesi i medias detyrohet në vend të dukshëm për secilin bartës të përmbajtjes individualish (psh. të një shembulli të medias së botuar dhe emision televiziv) të sigurojë shpalljen e të dhënave të mëposhtme: emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjigjës (redaktorit) të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i kryeredaktorit, dmth redaktorëve në pajtueshmëri me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin, adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur bëhet fjalë për mediat e shtypit. Për transmetuesit zbatohet në atë mënyrë që të dhënat shpallen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale. Botuesi i medias është i detyruar në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të shpallë të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i autorit për artikullin e botuar, emri dhe mbiemri i personit, dmth mbajtësi i të drejtës autoriale për përmbajtjet e shpallura, përveç se në mediat e shtypit dhe radio programet, data e produksionit (muaji dhe viti) kur bëhet fjalë për vepra audio/audi vizuale, origjina e veprave audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga një produksion i pavarur dhe informacioni për të, emrin e personit, dmth emrin dhe mbiemrin e personit që ruan pasurinë e vjetër kulturore të prodhuar ose vepër arkivore, pra një reproduksion i shkëlqyer dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë fragmenti programor ose pjesë nga fragmenti programor, nëse me marrëveshje reciproke nuk është rregulluar ndryshe. .

Në pajtueshmëri me pikën 10 nga Udhëzuesi për plotësimin e detyrimeve për impresium dhe informacioneve në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 nga 09.10.2018., transmetuesi kur emeton programe të prodhimit të huaj, duhet të emetoj shpicën origjinale.

Në kornizat e kompetencave të saja ligjore, Agjencioni përmes Sektorit për punë programore, më 25 shkurt 2022., ka kryer kontroll mbikëqyrës administrativë ndaj shërbimit programor televiziv SHTR TV DUE Nazim SHPKNJP Gostivar, emetuar më 18-të shkurt 2022., ku konstatoi se subjekti i mbikëqyrtur nuk ka vepruar sipas Vendimit për shqiptimin e masës – vërejtje publike (Up.nr.03-455 nga 27.12.2021.), d.m.th nuk ka mënjanuar shkeljen e kryer të nenit 14 nga LM. Pra, me mbikëqyrjen është konstatuar se në pjesë të programeve të emetuara më 18 shkurt 2022., nuk janë shpallur të dhëna me të cilat: identifikohen autorët pjesëmarrës në përgatitjen e përmbajtjeve audiovizuale, për mbajtësin e të drejtës autoriale, për redaktorin/redaktorët përgjegjës të programeve, për origjinën dhe datën e prodhimit të veprave audiovizuale, pra të mediumit nga ku është marrë përmbajtja etj., që transmetuesi është i obliguar ti emetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzuesit për plotësim të detyrimeve për impresium dhe informacioneve të disponueshme për përdoruesit (kur emeton programe të prodhimit të huaj, televizioni duhet të emetojë shpicën origjinale), në programet „Të gatujmë me z-Tefta” program dokumentar - argëtues, „Just for laughs-GAGS“, „Fakte interesante“ dhe seriali artistik „Perla e zezë“, nuk janë shpallur të dhëna për impresium, pra nuk është emetuar shpica origjinale e çlajmërimit të programit.

Shkelja nga paragrafi 1 nga kjo pikë, është specifikuar në Raportin me shkrim nga mbikëqyrja administrative e kryer, ark.nr. 10-807/1 nga 25.02.2022., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi në Shtojcën nr.1.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAV, Këshilli i Agjencisë deri tek SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar më 28.02.2022., dërgoj Korrespondencë me nr.ark.10-807/2 nga 28.02.2022. i cili i dorëzoi Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-807/1 nga 25.02.2022., me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të korrespondencës, deri tek Këshilli i Agjencisë të paraqesë një deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Korrespondenca është pranuar me rregull më 02.03.2022. Në afatin e paraparë, SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar nuk ka shpjeguar për shkeljen e bërë të dispozitave nga LM.

Në pajtueshmëri me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-320/4 nga 24.01.2020., për konstatim të shkeljeve gjatë vitit, për të cilat ishin shqiptuar masa një vit më parë, Këshilli i Agjencisë do të shqiptojë sërish masën vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzues për caktimin e afatit për të vepruar sipas Vendimit të Agjencisë nr.01-6039/1 nga 20.10.2015.

Prandaj, duke marrë parasysh se Vendim për shqiptim mase – vërejtje publike (Up1 nr.03-455 nga 27.12.2021.) u miratua në 2021., në pajtueshmëri me Raportin me shkrim për mbikëqyrje administrative të kryer me ark.nr.10-807/1 nga 25.02.2022. shkelje e pikës 1. të këtij Vendimi është kryer më 18 shkurt 2022., Këshilli i Agjencisë vendosi ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, në pajtueshmëri me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-320/4 nga 24.01.2020 për shqiptim të masës – vërejtje publike.

Në vijim të konkluzës, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 pika 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 pika 1 nga LSHMAV, dhe në lidhje me nenin 14 nga LM, pika 10 nga Udhëzuesi për plotësimin e detyrimeve

për impresium dhe informacione të disponueshme për përdoruesin, pika 14 nga Udhëzuesi për përcaktim të afatit për të vepruar sipas vendimit të Agjencisë për shqiptim të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje administrative të kryer ark.nr. 10-807/1 nga 25.02.2022. dhe Konkluzionin ark.nr.02-1036/4 nga 18.03.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LM, të përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 18.03.2022., miratoi Vendim duke paralajmëruar publikisht SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar ku obligohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrjen e kontrollit, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtueshmëri me nenin 24 nga LSHMAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa më sipër u përmend, u miratua vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale,
Kryetar i këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij aktëvendimi transmetuesi mund të ngrejë padi në gjykatën kompetente për inicimin e kontestit gjyqësor. Padia për inicimin e kontekstit gjyqësor paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Shtojca (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-807/1 nga 25.02.2022.